

ESMERALDA PATOSHI (SEFA)

PËR NJË FJALOR TË PROZËS SË DRITËRO AGOLLIT

HYRJE

Një nga sfidat e leksikologjisë shqiptare sot është pikërisht hartimi i një fjalori normativ, ku të përfshihen të gjitha fjalët. Fjalori në tërësinë e tij është një rezultat akumulues i biografive të ndryshme gjuhësore, të cilat në radhë murosën në procesin historik-gjuhësor. Nëse duam të shohim zhvillimin e gjuhës, duhet patjetër të ndalemi në veprat letrare, pasi aty gjuha rrjedh në përgjithësi nga të gjitha varietetet e gjuhës dhe nga regjistrat leksikorë të alternuar në kombinimet e tyre kryesore. Gjuha letrare e shkrimtarëve është e shumanshme jo vetëm në ndryshueshmërinë që i përket subjektit dhe formës, por gjithashtu në profilin historik individual të tyre. Pra, për të dhënë thelbin e revolucioneve letrare në periudha të ndryshme, duhen parë pikëpamjet e reja gjuhësore. Çdo shkrimtar ka individualitetin e vet, ky individualitet semantik u referohet ngarkesave emocionale dhe tematike të fjalëve të caktuara, në këtë mënyrë ato fitojnë vlerë specifike. Kjo përfshin krijimin e kuptimit të semantikës inovative. Sot për të parë vargun e gjerdanit gjuhësor të shqipes na nevojiten fjalorë të autorëve të tillë, si: Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Gjergj Fishta, Martin Camaj, Lasgush Poradeci etj., qofshin këta fjalorë rimorë apo fjalorë të prozës së këtyre shkrimtarëve të mëdhenj të letërsisë sonë. “I pari që ka nisur hartimin e fjalorëve për një shkrimtar është Kolë Ashta “Fjalori i veprave të Ndre Mjedës” (Ashta, 1995, dorëshkrim). Gjithashtu Mina Gero së fundmi ka nxjerrë në botim “Fjalori rimor i Dritëro Agollit” (Gero, 2013, 740).

ZHVILLIMI

Mbi këtë rrugë të shkelur më parë nga këta studiues të gjuhës sonë po vazhdoj të eci edhe unë, duke punuar mbi hartimin e “Fjalësit në prozën e D. Agollit”. Kështu studimi mbi gjuhën e këtij shkrimtari do të vijë më i plotë, duke nxjerrë përfundime mbi individualitetin e tij gjuhësor. Sa për Dritëro Agollin do të thosha që është artist i madh i fjalës shqipe. Leksiku në veprën e Agollit përfshin njësi të njohura, pak të njohura a të panjohura dhe mund të vështrohet nga disa anë. Autori shquhet për njohjen e thellë leksikore e semantike të shqipes dhe jo vetëm i përdor fjalët shqipe zotësisht, por edhe ripërtërin pasurinë e madhe që ka gjuha shqipe. Ai

shquhet për njohje të thellë të mundësive dhe aftësive të mëdha të shqipes për krijimin e njësive të reja dhe vetë krijon me qindra e qindra. Në veprën e Agollit fjala, si për nga kuptimi, ashtu edhe nga përbërja e saj tingullore, përmban në vetvete një copëz historie të folësve që e përdorin atë. Për këtë arsye shkrimtari kërkon me kujdes atë trajtë që i përshtatet më shumë temës dhe idesë së tij, vendit e kohës për të cilën bëhet fjalë. Ai herë e nxjerr atë nga harresa duke e risjellë në jetë ashtu siç është ose duke i dhënë një ngjyrim të ri kuptimor a stilistikor, dhe herë nga dialektet për ta futur në gjuhën e letërsisë artistike. Një nga burimet shprehëse në letërsinë artistike është krijimi i fjalëve dhe i kuptimeve të reja, dukuri kjo që haset edhe në veprën e Dritëro Agollit. Me anë të fjalëkrijimit ai emërton nocione të reja ose nocione të njohura, por në mënyrë të re. Kështu p.sh. shkrimtari formon fjalë me prapashtesat *-kë*, *-ka*, *-(ë)z* jo vetëm me kuptim zvogëlues ose përkëdhelës, por edhe me nënkuptim tallës ose nënvleftësues. Mund të përmendim fjalë të tilla, si: *amazonka*, *konkë*, *vulkën*, *guvernandka* etj. Gjithashtu shkrimtari përdor fjalët me kuptim keqësues, si: *mynafikllëk*, *akraballëk*, *matrapazllëk* etj., me prapashtesën turke *-llëk*, këto shprehin një qëndrim të shkrimtarit a të personazheve të tij, janë një mënyrë mjaft e njohur dhe karakteristike për ligjërimin bisedor të shqipes, të cilën Agolli e fut me mjeshtëri në ligjërimin e tij artistik. Për të shprehur vështrimin e tij mbi realitetin, shkrimtari përdor fjalë të reja duke ndërthurur nocione. Kështu p.sh. për të shprehur atdhedashurinë apo qëndresën, gjejmë fjalë të tilla si: *mëmëdhetari*, për të shprehur qëndresën gjejmë fjalë si: *kështjellar*; për të shprehur një periudhë të largët përdor fjalë si: *qëmotshëm* etj. Fjalë të reja te vepra e Dritëroit shohim edhe për të shprehur nocione të hapësirës si: *tejmbanë*; apo fjalë kompozita të formuara nga dy a më shumë nocione të ndryshme si: *qëllimlig*; apo fjalë me nocione të kundërta, çka nuk është e zakonshme për gjuhën shqipe si: *dritëshkurtër*, *filoshqiptar*, *pseudoshkencëtarë*, *qejfprishur* apo fjalë për të shprehur nocione krejtësisht irreale, si: *qoftëlargu* etj. Autori përdor edhe fjalë të tilla si: *autorizmin*, *narcisizmin*, të formuara mbi bazën e proceseve dhe fjalëve të njohura: *romanizim*, *osmanizim* etj. Ka raste kur autori përdor jo pak turqizma që t'i japë lexuesit ngjyrat e mjedisit të kohës së Perandorisë Osmane. Me këto fjalë autori tregon dhe rrezikun që e kërcënonte me zhdukje gjuhën shqipe. Për këtë arsye Agolli përdor huazime turke nga fusha të ndryshme si: *allajbe*, *araba*, *yzmetçi*, *aksham*, *haber*, *sabah*, *dynja*, *xhezve*, *Zylo* etj. Shqyrtimi i turqizmave në veprën e Dritëro Agollit nxjerrë në pah se shumica e tyre kanë vend vetëm në gjuhën e shkruar të letërsisë artistike. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre

është bërë në mënyrë të tillë që këtë ta ndiej e ta kuptojë lehtë edhe lexuesi. Pra, në veprën e Agollit ato kryejnë një punë të dyfishtë: nga njëra anë ndihmojnë shkrimtarin që të shprehë idenë e tij me ngjyra të holla e të gjalla dhe nga ana tjetër japin ndihmesë në zhvlerësimin e turqizmeve. Në veprën e shkrimtarit, bota jo e gjallë vepron me ndjesitë e ndjenjat e qenies së gjallë njerëzore. Nga ana gjuhësore kjo arrihet duke krijuar lidhje të reja midis fjalëve, pra lidhje të reja shoqëimore, p.sh.: *Shfryn përroi i jetës dhe shkëputet nga shpirti thirrje, dhimbje, ulërima, qeshje e mendime të trazuara. Këmisha i valëvitej si flakë e bardhë tek rrinte krenare mbi kalë* etj. Në veprën e Agollit shohim prirjen për përdorimin e leksikut dialektor, i cili përbën një nga tiparet e gjuhës së shkrimtarit, gjithashtu këto fjalë shprehin edhe përpjekjet për pasurimin e njësimit e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe. Nga kategoria e krijimeve gjuhësore të Dritëroit po veçojmë formimet me prapashtesën -shëm. Kjo prapashtesë është e gegërishtes veriore, por ato fjalë tërheqin vëmendjen jo vetëm për nga denduria, por edhe për nga mënyra e formimit dhe e evolucionit të tyre semantik, p.sh.: *qëmotshëm, papërsëritshëm* etj. Shkrimtari kujdeset të kumtojë ashtu siç duhet fjalët, duke zgjedhur sinonimin e duhur dhe kuptimin stilistikor e emocional të fjalëve. Të gjitha këto i japin gjuhës, sidomos asaj të shkruar, një shprehësi të lartë. Shkrimtari nuk lë mënjanë frazeologjinë si njësi gjuhësore me shprehësi të lartë, që spikat më shumë në gjuhën popullore: *gjuha kocka s'ka dhe kocka thyen* (Agolli, 1997, 246); *kush tallet me pleqtë, tall të ardhmen e vet; fleta është e lehtë, po mban lisin; nga avllia duket shtëpia; mishi flet gjuhën e barit* (Agolli, 1997, 328); *oxhaku djeg drutë, goja djeg fjalët* (Agolli, 1997, 331); *gjuha zbulon dhe e mbulon njerinë* (Agolli, 1997, 331); *poeti sheh ëndërra në diell dhe shkruan për shiun* (Agolli, 1997, 331) etj. Një veçori e gjuhës shqipe është edhe mënyra dëshirore, lexuesi njihet me këtë mënyrë të foljes në raste të tilla si: *Po ku e fute makinën, thefsh qafën, e më qafsh, do ta therësh; të rrofshin fëmijët dhe gruaja; m'u shoftë shtëpia që heq dorë nga letrat; të hëngërt flama; në u ç'mendsha në Tiranë dhe në më shpënshtin në çmendinë në Elbasan ...; edhe unë sonte jam një indus që falet para teje dhe në shkofta ndonjëherë në Indi; mirë bën, edhe në e bëftë ...; dhe tani mbeçi me shëndet; paç shëndet të përhershëm; më rrofsh moj xhane* (Agolli, 1997, 30-126) etj.

PËRFUNDIME

Gjuha letrare e shkrimtarëve është e shumanshme jo vetëm në ndryshueshmërinë që i përket subjektit dhe formës, por gjithashtu në profilin historik e tyre individual. Pra, për të dhënë thelbin e revolucioneve

letrare në periudha të ndryshme, duhen parë pikëpamjet e reja gjuhësore. Çdo shkrimtar ka individualitetin e vet, ky individualitet semantik u referohet ngarkesave emocionale dhe tematike të fjalëve të caktuara, në këtë mënyrë ato fitojnë vlerë specifike. Kjo përfshin krijimin e kuptimit të semantikës inovative. Ashtu siç e përmenda edhe më lart, leksiku në veprën e Agollit është tepër i pasur e për këtë arsye ajo ka një vend të veçantë në gjerdanin gjuhësor të shqipes. Në veprën e Agollit kemi një larmishmëri fjalësh, një leksik aq të pasur sa të duket njëherë sikur po lexon një autor të zonës së Devollit e brenda pak faqesh gjithçka ndryshon, sheh një autor që i përket dialektit gegë. Brenda së njëjtës vepër kemi fjalë tepër të vjetra, dialektizma (si të dialektit gegë, ashtu dhe atij toskë), fjalë të reja (neologjizma), fjalë të huazuara nga turqishtja, fjalë të huazuara nga fjalori i gjuhës italiane apo angleze, të cilat i janë nënshtruar rregullit morfo-sintaksor të gjuhës shqipe. Të gjitha këto të japin përshtypjen se kemi një shkrim autorësh brenda një vepre të vetme. Fjala në penën e Agollit merr jetë dhe transformohet duke na falur emocione, por duke dhënë edhe një vlerë të madhe në gjuhësinë tonë, duke krijuar fjalë të reja, kuptime të reja dhe duke nxjerrë në pah fjalën dhe përkatësinë e saj dialektore, se çfarë është e mbarë gjuhës sonë. Pra gjuha në veprën e Agollit është shumë e pasur dhe për të demonstruar këtë po japim disa shembuj nga vepra.

abazhur~i. *m.sh.~ë.~ët.* Mjet ndriçimi me një mbështetëse për llambën elektrike e me mbulesë qelqi, metali etj., që e mbledh dritën në një drejtim; mbulesa e këtij mjeti: ..., *ky nipi juaj Forja vështroi tre turq me mustaqe më të gjata sesa ai bastuni që mbani në dorë, aq të gjatë sa mund t'u shkonin kokat mbi këtë **abazhur** të kristaltë.* (Arka e Djallit, f. 415).

abon/oj~kal.~ova~uar. Bëj pajtim për në një organ shtypi, për në një linjë udhëtimi etj.: *Madje, edhe nëse ambasadave u shpëton ndonjë gjë, vjen në ndihmë ATSH-ja, që është **abonuar** jo vetëm në gazetatat dhe revistat më të mëdha botërore ...* (Arka e Djallit, f. 166)

abrash-i. *m.sh.~a.~at.* Njerëz me tipare tërësisht të bardha: *A të vjen në mend kur të thërrisnim me llagapin **abrash**.* (Njerëz të krisur, f. 315).

admirim~i. *m.* Ndjenja e këndshme që na lind kur admirojmë diçka; vlerësim i lartë e mirëdashës i diçkaje: *Ah! - bëri përsëri Xhibilet Xhibiletovi dhe e vështroi me **admirim** Cuten.* (Arka e Djallit, f. 201).

afarist~i. *m.sh. ~ë.~ët.* Sipërmarrës i madh privat,që nxjerr fitime me tregti, me investime etj.: ... *me gjeneralë buzëqeshës më vrasës, me*

- afaristë** *më dorështrënguar, me varfanjakë më llamburitës...* (Arka e Djallit, f. 195).
- afendiko~i.** *m.sh. ~nj.~njtë. bised.vjet.* Zotëri; pasanik (zakonisht si titull për të pasurit ortodoks): *Po sa jep afendikoji?* - bëri Pazar greku. (Arka e Djallit, f. 420).
- afërim~psth.** *thjeshtligj. Të lumtë:* "Çok gjyzel mustake, **afërim**, çok gjyzel!" (Arka e Djallit, f. 176).
- akraballë/k~ku.** *m.sh. ~qe.~qet. keq.* Përkrahje që iu jepet miqve e fafesisit në dëm të interesave të përgjithshëm, miqësi e sëmure: ... *janë thumbuar nga Bamka nëpër fejtone dhe skica humoristike për akraballëqet, hatëret, ryshfete e shpifjet.* (Arka e Djallit, f. 263).
- çember-i** *m.* Shami koke, lloj i veçantë për të mbuluar kokën që përdoret nga gratë e Korçës: *Fatimen, të thatë, të mbështjellë gjithmonë me një çember të zi deri mbi vetulla.* (Arka e Djallit, f. 7)
- çing~i.** *m.sh.~të fig.* Llojet e ndryshme të argëtimeve që bëheshin në hane, vallet që kërcëheshin nga gratë e që të kënaqin syrin etj.: *Ah, ç'mëkat u bë që humbëm hanet, ku tregoheshin ngjarjet më të mahnitshme, ku lindnin anekdotat dhe fjalët e urta më të papritura dhe ngacmuese, ku hidheshin çingitë më lozonjare, ku bëheshin rrahjet dhe hundëthyerjet më gjakderdhëse ...* (Arka e Djallit, f. 194).
- çorbaxhi~u.m** *tall.mospërf.fig.* Ai që bën çorbën, këtu që ngatërron gjërat, i përzien: *Po pusho, more çorbaxhi!* (Arka e Djallit, f. 322).
- hamburgeror/e~ja.** *f.* Vend ku hahen hamburger, ku shërbehen hamburger: ... *urat dhe mejhanet e Stambollit, pagodat dhe rosat pekineze të Pekinit, akropolet dhe kukuretoret e Athinës, kaukazkat dhe vodkat e Moskës, keçtoret dhe orizoret e Tokios, hamburgeroret dhe uiskëtoret e Nju-Yorkut, birra të buterbrodët e Berlinit e me rradhë.* (Arka e Djallit, f. 160).
- invazion~i.** *m.sh.~e.~et.* Pushtim: ... *kemi themeluar, përpunuar dhe zhvilluar këto zakone, duke i kthyer në ligje dhe kode morale për të betonuar qëndresën dhe ekzistencën tonë ndaj dyndjeve barbare dhe më vonë të invazioneve të makinës dhe mekanizmit kolosale të shteteve moderne.* (Arka e Djallit, f. 155).
- letrushk-a-at** *f.* Letër e shkruar, fletë të një libri të letërsisë, këtu përdoret me kuptim negativ, nënvlerësues: *Ky vanitoz kujton se bota jeton me letërsinë, se mendjen të gjithë e kanë në ato letrushkat që shkruajnë grafomanët ...* (Arka e Djallit, f. 11).

pijetar~i. m.sh~ë.~ët. Ai që pi vazhdimisht e me tepri pije alkoolike, ai që e ka ves të pirët: *Dhe ia mori këngës që bën fjalë për një pijetar qejfli: ...* (Arka Djallit, f. 76).

pijetor/e-ja. f.sh.-e-et. Lokal ku pihen pije alkoolike: *E vërteta e patundur është ajo që Bamkë Dynjaja i prish paratë kafeneve e pijetoreve, siç prish ti trikot e vjetra.* (Arka e Djallit, f. 39).

BIBLIOGRAFI

- Agolli, D. (1973), *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo*. Tiranë.
Agolli, D. (1975), *Njeriu me top*. Tiranë.
Agolli, D. (1980), *Trëndafili në gotë*. Tiranë.
Agolli, D. (1991), *Dështaku*. Tiranë.
Agolli, D. (1997), *Arka e djallit*. Tiranë.
Agolli, D. (2001), *Njerëz të krisur*, Tiranë.
Sotiri, N. (2007), *Fjalor i gjuhës së Ismail Kadares*. Tiranë.
Xhuvani, A., Çabej, E. (1962), *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë.
Demiraj, SH. (1977), *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*. Tiranë.
Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*.
Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1984), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.
Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2006), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.
Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1976), *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe (32000 fjalë)*. Tiranë.